



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 42/14 Prot.

Tiranë, më 17.11 2022

V E N D I M

Nr. 151, datë, 17. 11. 2022

PËR DHËNIE MASE DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim oficerit të policisë gjyqësore Petrit Caku, dëgjoi pretendimet e tij dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm, nr.892/4 ex 21 datë 23.09.2022, "Për procedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Petrit Caku", protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore, me numer protokolli 42, datë 23.09.2022, Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", ka nxjerrë Urdhërin nr.114, datë 07.10.2022 "Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Petrit Caku, për kryerjen e shkeljes disiplinore në formën :

"veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proceseve hetimore", parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", **neni 33, pika 2, gërma "a"**.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për propozimin për fillimin e procedimit disiplinor kanë shërbyer veprimet dhe mosveprimet, në shkelje të kërkesave të Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit 25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Petrit Caku, gjatë hetimit të 17 procedimeve penale, dhe konkretisht,

Procedimi penal **nr.226**, datë 05.02.2020, Procedimi penal **nr. 155**, datë 24.01.2020, Procedimi penal **nr.845**, datë 25.04.2019, Procedimi penal **nr.1643**, datë 02.09.2019, Procedimi penal **nr.280**, datë 12.02.2020, Procedimi penal **nr.1138**, datë 04.07.2018, Procedimi penal **nr.1011**, datë 12.06.2018, Procedimi penal **nr.2381**, datë 04.12.2019, Procedimi penal **nr.179**, datë 28.01.2019, Procedimi penal **nr.1315**, datë 04.09.2020, Procedimi penal **nr.576**, datë 10.04.2020, Procedimi penal **nr.2298**, datë 18.11.2019, Procedimi penal **nr.1865**, datë 17.09.2019, Procedimi penal **nr.1996**, datë 04.10.2019, Procedimi penal **nr.1022**, datë 26.05.2019, Procedimi penal **nr.21**, datë 06.01.2021, Procedimi penal **nr.34**, datë 04.01.2019

Nga aktet që u administruan gjatë seances dëgjimore per proçedimin disiplinor, u provua se:

2.1 Prokuroria e Përgjithshme, mbi bazën e Urdhërit Nr.61 datë 02.06.2021, të Prokurorit të Përgjithshëm, ka ushtruar kontroll mbi treguesi e punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, të Seksionit të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për vitin 2021.

Objekti i kontrollit ishte ligjshmëria e veprimeve hetimore të oficerëve të Policisë Gjyqësore në;

- Procedimet penale të regjistruara nga data 01.05.2020 – 31.05.2021 dhe ato të mbartura nga vitit 2019, për të cilat është vendosur pushimi i procedimit penal, janë dërguar për gjykim, apo nuk kanë përfunduar hetimet dhe janë mbartur për vitin 2021.

- Mosfillimet e procedimeve penale të vendosura për materialet kallëzuese/referuese të regjistruara prej datës 01.05.2020 – 31.05.2021.

- Disiplina në punë.

Nga ana e grupit të punës, në përfundim të procesit të kontrollit të ushtruar për cdo oficer të policisë gjyqësore, është përpiluar raporti përfundimtar përmbledhës në të cilan janë pasqyruar problematikat si në nivel organizativ të punës së seksionit të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ashtu dhe në nivel individual për secilin oficer të policisë gjyqësore.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar për periudhën objekt inspektimi u konstatua se, ne hetimin e procedimeve penale të hetuara nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, në disa prej tyre janë lejuar zvarritje në hetim dhe nuk janë respektuar afatet e caktuara në urdhërin e prokurorit të çështjes, për kryerjen e veprimeve hetimore.

Zvarritjet e veprimeve hetimore janë të pajustificuara dhe në shkelje të dispozitave ligjore të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të cilat rregullojnë dhe disiplinojnë hetimin dhe afatet e tij.

2.2. Sikurse rezulton nga aktet e administruara në seancën dëgjimore, në datën 05.02.2020, Prokuroria Elbasan ka regjistruar proçedimin penal nr.226, për veprat penale “Fallsifikimi i

dokumentave” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të K.Penal, pushuar në datën 23.12.2020.

Për këtë procedim penal konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara, nga prokurori dhe oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku për 8 muaj.

Urdhëri i prokurorit të çështjes për kryerjen e veprimeve hetimore mban datën 05.02.2020, ndërsa veprimi i parë hetimor, marrja e deklarimeve të një shtetasi, nga oficeri i policisë gjyqësore Petrit Caku, është kryer në datën 04.03.2020. Veprimi i fundit hetimor është kryer në datën 03.11.2020, jashtë afatit të caktuar nga prokurori dhe me shumë vonesë.

Veprimet hetimore të kryera për këtë procedim penal janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim për tetë muaj. Nga aktet e dosjes rezulton se nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku janë kryer vetëm disa veprime hetimore, marrja e tre deklarimeve gjatë muajit mars 2020, mandej deri në datën 03.11.2020 nuk është kryer ndonjë veprim i mirfilltë hetimor. Ka përpiluar 2 shkresa drejtuar institucioneve të tjera, një në datën 12.06.2020 dhe tjetra në datën 28.10.2020. Në periudhën midis tyre, për tre muaj, nuk është kryer asnjë veprim hetimor.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për një periudhë të gjatë.

2.3. Në datën 24.01.2020, është regjistruar procedimi penal **nr.155**, për veprën penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i K.Penal, pushuar në datën 02.12.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara, nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku për 6 muaj.

Rezulton se prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, në datën 15.05.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Petrit Caku për 6 muaj. Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim dhe për gjashtë muaj të tjera. Nga aktet e dosjes rezulton se nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, nga data 15.05.2020, kur i është deleguar kryerja e veprimeve hetimore, është kryer vetëm një veprim hetimor, (kqyrje dokumentacioni) dhe ka dërguar disa urdhëra për thirjen e shtetasve për tu pyetur.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 6 muaj.

2.4. Në datën 24.04.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.845**, për veprën penale “Vetëgjyqësia”, parashikuar nga neni 277 i K.Penal, pushuar datë 18.06.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku për 11 muaj.

Rezulton se prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, në datën 25.04.2019. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Petrit Caku për 11 muaj. Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e proçedimit në hetim për 11 muaj. Nga aktet e dosjes rezulton se nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, nga data e lëshimit të urdhërit të prokurorit për kryerjen e veprimeve hetimore 25.04.2019 deri në datën 20.05.2020 pothuajse nuk është kryer asnjë veprim i mirfilltë hetimor. Gjatë kësaj periudhe janë pyetur si deklarues dy persona, në datën 16.07.2019 dhe 17.07.2019 dhe është mbajtur një procesverbal për kqyrjen e sistemit të QKB, dhe nuk janë kryer veprime të tjera hetimore.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 11 muaj.

2.5. Në datën 02.09.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.1643**, për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/2 i K.Penal, zgjidhur me marrëveshje në datën 17.07.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku për 7 muaj.

Rezulton se prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, në datën 24.11.2019. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Petrit Caku për 7 muaj. Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e proçedimit në hetim për shtatë muaj. Nga aktet e dosjes rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, ka realizuar pyetjen e një deklaruesi si person që tregon rrethana të hetimit, datë 25.10.2019, ka administruar disa akte shkresore si dhe ka administruar aktin e ekspertimit, veprime të cilat nuk kërkonin një kohë kaq të gjatë për kryerjen e tyre.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 7 muaj.

2.6 Në datën 12.02.2020 është regjistruar **procedimi penal nr.280**, për veprat penale “Falsifikimi i dokumentave” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal, pushuar në datën 24.12.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku për 10 muaj.

Rezulton se prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, në datën 13.02.2020. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Petrit Caku për gati 10 muaj. Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e proçedimit në hetim për 10 muaj. Nga aktet e dosjes rezulton oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, ka realizuar pyetjen e një deklaruesi si person që tregon rrethana të hetimit, datë 12.02.2020 dhe ka administruar disa akte shkresore, veprime të cilat

nuk kërkonin një kohë kaq të gjatë për kryerjen e tyre. Nuk justifikohet zvaritja në hetime me argumentin sepse institucionet e tjera kanë vonuar kthimin e përgjigjeve të kërkuara me shkresë nga prokuroria. Nuk është bërë asnjë përpjekje dhe nuk rezulton ndonjë veprim nga oficeri i policisë gjyqësore për të nxitur këto institucione për tu përgjigjur në kohë.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 10 muaj.

2.7 Në datën 04.07.2018 është regjistruar **procedimi penal nr.1138**, për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/4 i K.Penal, dërguar gjyqit 15.12.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit, të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimtarisë hetimore. Procedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara mbi 2 vjet e 4 muaj.

Nga aktet e dosjes rezulton se fillimisht dosja është mbajtur pa veprime për 1 vit e 9 muaj nga oficeri i Policisë Gjyqësore Olsi Marku. Më pas, në datën 04.02.2020 procedimi penal i ka kaluar për ndjekje oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Caku. Por edhe pas kësaj, hetimet janë zvaritur pa arsye duke mbajtur dosjen me shumë pak veprime hetimore edhe për 7 muaj të tjerë, duke bërë që dosja të mbahet pa shkaqe të arsyeshme për 2 vjet e 4 muaj. Veprimet hetimore të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore janë shumë të pakta, një procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, datë 14.02.2020, procesverbali pyetjes së të pandehurit, datë 04.12.2020 dhe janë administruar disa shkresa.

2.8 Në datën 12.06.2018 është regjistruar **procedimi penal nr.1011**, për veprën penale “Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”, parashikuar nga neni 324/a/1 i K.Penal, dërguar gjyqit në datën 25.09.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Hetimi i procedimit penal ka zgjatur tej çdo afati të arsyeshëm, për 2 vjet e 3 muaj. Nga ana e prokurorit të çështjes janë nxjerrë 2 urdhëra për kryerjen e veprimeve hetimore, urdhëri dates 12.06.2018 dhe urdhëri dates 04.02.2020. Për të dy urdhërat janë shkelur afatet e caktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore.

Oficeri Policisë Gjyqësore Petrit Caku parashtron se prej tij dosja është mbajtur në hetim jo për 2 vjet e 3 muaj, por për 1 vit e 8 muaj, duke pretenduar se nuk ka zvarritje të hetimit. Nga aktet e dosjes rezulton se mbajtja e dosjes edhe për 1 vit e 8 muaj, është tej çdo afati të arsyeshëm. Për më tepër, veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit në hetim për 1 vit e 8 muaj. Veprimet e kryera janë vetëm administrimi i akteve shkresore.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për një periudhë të gatë dhe ka shkelur afatet e caktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore.

2.9 Në datën 04.12.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.2381**, për veprat penale “Plagosja e lehtë me dashje” dhe “Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga nenet 89 dhe 301 të K.Penal, pushuar datë 30.06.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit, të cilat konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimtarisë hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara mbi 6 muaj. Prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, në datën 05.12.2019. Pas kësaj date, dosja është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Petrit Caku për 5 muaj. Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e dosjes në hetim për 5 muaj.

Për sa më sipër, rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Rasim Guzi, pa shkaqe të arsyeshme, ka zvarritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 5 muaj.

2.10 Në datën 18.11.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.2298**, për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 e 25 i K.Penal, dërguar për gjykim në datën 20.01.2021

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Për një periudhë 1 vjeçare, nga momenti i regjistrimit procedimit penal, 18.11.2019 deri në datën 16.11.2020, dosja është mbajtur në dorë pa u kryer asnjë veprim hetimor.

Veprimet hetimore të kryera për këtë proçedim penal janë shumë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e proçedimit në hetim për një periudhë kaq të gjatë.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku pretendon se dosja hetimore është mbajtur nga prokurori dhe se ai e ka marrë atë në muajin nëntor 2019, por nuk paraqiti prova për të vërtetuar këtë pretendim.

2.11 Në datën 17.09.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.1865**, për veprën penale “Pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave”, parashikuar nga neni 320 i K.Penal, dërguar gjyqit datë 18.12.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore dhe mbajtjen e dosjes pa veprime për periudha të gjata kohe. Prokurori i çështjes ka lëshuar dy urdhëra për kryerjen e veprimeve hetimore, datë 17.09.2020 dhe datë 09.12.2020. Në të dy rastet nuk janë respektuar afatet e caktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore. Rezulton se nga data 23.10.2019 deri në datën 07.04.2020 nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara për 1 vit e 3 muaj. Veprimet hetimore të kryera janë shumë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e procedimit penal për një kohë kaq të gjatë në hetim.

2.12. Në datën 04.10.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.1996**, për veprën penale “Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit”, parashikuar nga neni 242 i K.Penal, dërguar për gjykim datë 10.07.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në vijueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara për 9

muaj. Rezulton se prokurori i çështjes në datën 14.10.2019 ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore. Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, nuk është respektuar ky afat, por dosja është mbajtur prej tij pa shkaqe të justifikuara deri në datën 03.07.2020. Për periudhat 04.10.2019 – 19.02.2020; 25.02.2020 – 01.07.2020 nuk është kryer asnjë veprim hetimor me mosveprimet e tij, oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku ka zvaritur hetimet e proçedimit penal për 9 muaj.

2.13. Në datën 26.05.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.1022**, për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 i K.Penal, dërguar për gjykim në datën 23.11.2020.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Hetimi për këtë procedim penal ka zgjatur 1 vit e 6 muaj. Nga momenti i regjistrimit procedimit penal, 26.05.2019 deri në datën 07.04.2020, dosja është mbajtur nga prokurori i çështjes dhe nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Prokurori çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore, në datën 07.04.2020. Pas kësaj date, proçedimi penal është mbajtur nga oficeri i Policisë Gjyqësore, Petrit Caku edhe për 6 muaj.

Veprimet hetimore të kryera gjatë kësaj periudhe janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e proçedimit në hetim dhe për 6 muaj të tjerë. Rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku ka shkelur afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvaritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 6 muaj.

2.14. Në datën 06.01.2021 është regjistruar **procedimi penal nr.21**, për veprat penale “Goditjet për shkak të detyrës” dhe “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga nenet 237 dhe 291 të K.Penal, dërguar gjyqit në datën 06.06.2021.

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim për 5 muaj, ndërkohë që të gjitha veprimet e nevojshme hetimore janë kryer dhe administruar brenda afatit 3 mujor.

Në datën 22.01.2021 prokurori i çështjes ka nxjerrë urdhërin për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pas kësaj date procedimi penal është mbajtur për 5 muaj nga oficeri i policisë gjyqësore Petrit Caku.

Veprimet hetimore të kryera pas marrjes së procedimit nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku janë të pakta dhe nuk justifikojnë mbajtjen e proçedimit në hetim prej tij për pesë muaj. Rezulton se oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, ka shkelur afatin e caktuar nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe pa shkaqe të arsyeshme, ka zvaritur hetimet duke mbajtur dosjen pa veprime për 5 muaj.

2.15. Në datën 04.01.2019 është regjistruar **procedimi penal nr.34**, për veprën penale “Dhënia ndihmë një të burgosuri për largim”, parashikuar nga neni 324-a/1 K.Penal, dërguar për gjykim në datën 13.11.2020

Konstatohen zvarritje të pajustificuara gjatë hetimit që konsistojnë në mosvijueshmërinë e kryerjes se veprimeve hetimore dhe mbajtjen e dosjes pa veprime për periudha të gjata kohe. Prokurori i çështjes ka lëshuar dy urdhëra për kryerjen e veprimeve hetimore, datë 04.01.2019

dhe 08.09.2020. Në të dy rastet nuk janë respektuar afatet e caktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore. Proçedimi penal është mbajtur në hetim pa shkaqe të justifikuara për 1 vit e 10 muaj. Veprimet hetimore të kryera janë shumë të pakta dhe nuk mjustifikojnë mbajtjen e procedimit penal për një kohë kaq të gjatë në hetim. Për afro 1 vit e 5 muaj nga oficeri i policisë gjyqësore Petrit Caku është marrë vetëm 1 deklaram nga personi që ka dijeni për rrethanat e hetimit; një procesverbal për terheqje ankimi; një procesverbal për këqyrjen e sistemit TIMS; një shkresë dërguar kompanisë Vodafone. Nuk është kryer asnjë veprim i mirefilltë hetimor.

2.18 Lidhur me **3** proçedime penale, të cilët përfshihet në propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, në grupin e proçedimeve penale për të cilat kërkohet proçedimi disiplinor, Komisioni nuk konstaton zvarritje në hetimin e këtyre proçedimeve penale, nga ana e oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Caku.

Komisioni i Policisë Gjyqësore, pas administrimit të provave të paraqitura nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, arriti në përfundimin se në proçedimet penale, **nr.179**, regjistruar në datën 28.01.2019, **nr.1315** i vitit 2020 dhe **nr.576** i vitit 2020, nuk evidentohen veprime apo moveprime të tij që pasjellin zvarritje në hetimin e këtyre proçedimeve penale. Këto proçedime penale janë hetuar nga oficerë të tjerë dhe oficeri Petrit Caku ka kryer vetëm veprimin hetimor të përfundimit të hetimeve.

3. Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, analiza e tyre dhe shpjegimet e vetë subjektit të proçedimit disiplinor, provohet se gjatë hetimit të **14** proçedimeve penale, të trajtuara më lart, nga ana e oficerit të policisë gjyqësore Petrit Caku, janë shkelur kërkesat e Kodit të Proçedurës Penale, që disiplinojnë afatet e hetimit dhe dispozitat e Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore që rregullojnë mardhëniet midis oficerit të Policisë Gjyqësore dhe Prokurorit. Sikurse rezultojnë nga aktet e dosjeve penale të sipërcituara, shumë veprime hetimore janë kryer tej afatit të caktuar në urdherin e delegimit të prokurorit dhe tej afatit 3 mujor që parashikon neni 323 i K.K.Pr.Penale. Neni 323 i K.Pr.Penale parshikon se afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilin emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale.”

Ndërsa në nenin 7, pika 2 të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, është parashikuar detyrimi që ka oficeri i Policisë Gjyqësore për të zbatuar urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve. Sikurse u provua gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, në kundërshtim me këtë detyrim ligjor, për 14 proçedimet penale që u trajtuan më sipër, oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku, nuk ka respektuar afatet e hetimit dhe afatet e caktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore dhe përfundimin e çështjes.

4. Në çmim të Komisionit, shkeljet e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, lidhur me afatin e hetimeve dhe moskryerja e veprimeve hetimore brenda afateve të parashikuara në ligj dhe urdhërin e delegimit të prokurorit, nga oficeri i policisë gjyqësore Petrit Caku, për vetë natyrën e tyre

dhe pasojat që sjellin, përbëjnë shkelje disiplinore, të parashikuar nga neni 33 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”

Komisioni vlerëson se shkelja e kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale, dhe nenit 7 të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, mbajtja në dorë e proçedimit penal, pa kryer veprime hetimore dhe kryerja e tyre jashtë afateve të caktuara nga prokurori, përbëjnë shkelje disiplinore në formën, **“veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të policisë gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje të proçeseve hetimore”**, parashikuar nga **neni 33, pika 2, gërma “a” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

4.1. Lidhur me këto shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Petrit Caku, nuk i pranon ato dhe shpjegon se vonesat dhe zvarritjet kanë ardhur për shkak të ngarkesës së madhe që ai ka patur në këtë periudhë, se dosjet janë mbajtur nga oficerë të policisë gjyqësore që i kanë patur më parë këto dosje dhe se shka është bërë dhe pandemia, kufizimi i veprimeve në këtë situatë.

Këto shpjegime dhe pretendime të oficerit të policisë gjyqësore Petrit Caku, nuk justifikojnë shkeljet e kryera dhe vonesat e gjata në hetimin e proçedimeve penale.

Referuar, ligjit nr.25/2019 “Për funksionimin dhe organizimin e Policisë Gjyqësore”, nenit 7, pika 2, oficerët e Policisë Gjyqësore, kanë detyrimin ligjor të zbatojnë urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit për përcaktimin e çështjeve që duhen hetuar me përparësi, e veprimeve konkrete që duhen kryer, si dhe për kohëzgjatjen e nevojshme të hetimeve. Ndërsa në nenin 33, pika 2 e Kodit të Proçedurës Penale parashikohet detyrimi i Policisë Gjyqësore për të kryer detyrat që i janë caktuar nga prokurori dhe të njoftojë atë menjëherë mbi rezultatet e tyre. Për proçedimet penale objekt i shqyrtimit të këtij proçedimi disiplinor, prokurori ka caktuar veprimet hetimore që duhet të kryeshin dhe afatin brenda të cilit duhet të kryeshin nga oficeri i policisë gjyqësore, të cilat nuk janë respektuar nga oficeri i Policisë Gjyqësore Petrit Caku.

Mosrespektimi afateve të caktuara nga Kodi i Proçedurës Penale dhe prokurori, kryerja e veprimeve hetimore tej këtyre afateve, dhe mosnjoftimi i prokurorit, për rezultatet brenda afatit të caktuar prej tij, përbëjnë shkelje të dispozitave ligjore të sipërcituara dhe zvarritje në hetim, në kuptimin që Ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” jep për konceptin e zvarritjeve në hetim, të cilat sjellin si pasojë përgjegjësi disiplinore për oficerin e Policisë Gjyqësore.

Në thelb, afatet e hetimit të përcaktuara në Kodin e Proçedurës Penale janë afate për prokurorin. Sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, përgjegjës për hetimin e çështjes është prokurori. Ai ka përgjegjësinë për ecurinë e çështjes dhe përfundimin e saj në afatet që ka caktuar Kodi i Proçedurës Penale.

Oficeri i Policisë Gjyqësore veç parashikimeve të Kodit të Proçedurës Penale, kryesisht lidhet me urdhërat e prokurorit për afatet e hetimit. Prokurori i cakton ato në bazë të një plani që ai ka për hetimin dhe përfundimin e çështjes. Për oficerin e Policisë Gjyqësore, afate të hetimit janë ato që cakton prokurori në urdhërat për kryerjen e veprimeve hetimore.

5. Duke e konsideruar të provuar shkeljen disiplinore të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore Petrit Caku, Komisioni, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33 i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta;
- b) Të rënda;
- c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në gërmën “a”, pika 2, e nenit 33, parashikon si **shkelje të lehtë**, “*veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, të cilat passjellin zvarritje te proçeseve hetimore*”.

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Petrit Caku, Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljes disiplinore të kryera prej saj, pasojat që ato kanë sjellë, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit.

Gjithashtu Komisioni i referohet dispozitave të ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer.

Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas radhës, a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje me paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në një vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.

Në pikën 2 të nenit 34 parashikohet që, për shkeljet e lehta jepen masat disiplinore “vërejtje me shkrim” ose “vërejtje me paralajmërim”.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljeve konkrete të kryera, Komisioni çmon që ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Petrit Caku të japë masën disiplinore “**vërejtje me shkrim**”, parashikuar nga neni 34, pika 1, gërma “a” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “ç”, 11, pika 4, nenit 33, pika 2, gërmat “a”, dhe “c”, neni 34, pika 1, gërma “b”, dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore me katër vota pro.

V E N D O S I:

1. Oficerit të policisë gjyqësore Petrit Caku, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, i jepet masa disiplinore “**Vërejtje me shkrim**”.
2. Me këtë vendim, të njihet oficeri i policisë gjyqësore Petrit Caku, i cili, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Petrit Caku.

KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI

ANËTAR

ARJAN MUÇA
munjon

ANËTAR

HARI GOGO
[Signature]



ANËTAR

REDI VASILI
[Signature]

ANËTAR

ALBERT MUÇO
[Signature]